



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

RISITË QË I SJELL KURRIKULA E RE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

(INFORMATOR PËR PRINDËR)

KORRIK, 2017

Risitë që i sjell kurrikula e re në arsimin parauniversitar

Grupi punues:

Sahit Berisha
Merita Jonuzi
Arbër Salihu
Afërdita Kryeziu
Igballe Cakaj

Përmbajtja:

·Hyrje

·Qëllimi i informatorit

·Cilat janë risitë dhe çështjet kryesore të kurrikulës së re?

·Kurrikula e bazuar në kompetenca

·Cilat janë parimet e Kornizës Kurrikulare?

·Çka janë shkallët kurrikulare?

·Ç`kuptojmë me kurrikulën me bazë shkollë-mësimi me zgjedhje dhe aktivitetet tjera?

·Ç`kuptojmë me rezultatet e të nxënit?

·Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

·Pse dhe si vlerësohet nxënësi?

·Cilat janë periudhat e vlerësimit?

·Cili është roli i prindërve në mbështetje të zbatimit të Kornizës Kurrikulare?

·Përfundim

Hyrje

Sektori i arsimit në Kosovë karakterizohet për përpjekje të vazhdueshme drejt reformimit të të gjithë nënsektorëve që trajtojnë sfidat kryesore të rritjes së pjesëmarrjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim.

Kjo përpjekje synon t'i bëjë të gjithë qytetarët pa dallim subjektë aktivë të një shoqërie të dijes, e cila ndërtohet me mobilizim të të gjithëve dhe gatishmëri për punë cilësore brenda sistemit arsimor. Prandaj, orientimi ynë i përbashkët është rritja e cilësisë në arsim, konform realitetit të përmasave globale, pjesë e të cilit janë edhe shoqëria dhe sistemi ynë i arsimit.

Në këtë kontekst, që arsimit ynë të jetë i krahasueshëm me arsimin e vendeve të zhvilluara, jemi dëshmitarë se janë bërë dhe po bëhen zhvillime të ndryshme në të gjitha sferat e arsimit parauniversitar, si në: kurrikula, planprograme, standarde për tekste shkollore, dokumente për standarde dhe vlerësim, krijimin e hapësirave të reja shkollore, arsim profesional dhe atë joformal. Hapa me rëndësi janë bërë edhe në trajtimin në vazhdimësi të problemit të dhunës në shkolla dhe të braktisjes, në rritjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të fëmijëve në nivelin parashkollor në sistem të arsimit. Gjithashtu, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për integrimin e komuniteteve, si dhe për organizimin e mësimin plotësues në diasporë. Këto të gjitha, bashkë me fokusimin në të drejtat e fëmijëve/të njeriut në sistem të arsimit dhe ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në arsimin parauniversitar, çojnë në një perspektivë më të mirë për të gjithë, në rritjen e cilësisë së arsimit dhe në arritjen e gjithëpërfshirjes në arsim.

Të gjitha këto, po ashtu, janë pjesë e synimeve, e politikave dhe e strategjive të MASHT, prandaj rreth tyre kemi legjislacionin, përcjellë me akte nënligjore adekuate, por edhe me materiale tjera didaktike dhe udhëzues specifike për lehtësimin e punës së mësimdhënësve.

Tani prind i nderuar, me këtë material informativ po e vëmë theksin te risitë që i sjell kurrikula e re në arsim parauniversitar, e të cilat ofrojnë një filozofi të re që për bazë ka zhvillimin e kompetencave të nxënësit për arsimim tërëjetësor dhe për integrimin e tij të lehtë shoqëror, duke e përgatitur atë që të ballafaqohet me sfidatë jetës.

Kjo kurrikulë mësimdhënësit i ndihmon në planifikimin dhe realizimin e suksesshëm të punës me nxënës përmes aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë klase, drejt arritjes së kompetencave dhe shkathtësive për t'u përballë me sfidat e shekulli XXI dhe gjenerimit të dijeve të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës.

Ndërkaq, ty si prind të ofron mundësi në ndjekjen sakt të arritjeve të kompetencave të fëmijës tënd në periudha të caktuara kohore në bazë të njohurive, sjelljeve, ndjenjave dhe qëndrimeve që manifestojnë në situata të ndryshme jetësore, në harmoni me rezultatet e të nxënit të fushave dhe shkallëve kurrikulare

Qëllimi i informatorit

Nëpërmjet këtij informatori duam që prindërit dhe palët tjera të interesit të njihen me proceset e reja arsimore, konkretisht me dokumentet bazike kurrikulare, si dhe të bëhen pjesë aktive e partneritetit në zbatimin efikas të tyre.

Cilat janë risitë dhe çështjet kryesore të kurrikulës së re?

Risitë e kurrikulës së re janë: qasja në kompetenca dhe rezultate të të nxënit, riorganizimi i fushave kurrikulare dhe shkallëve kryesore të kurrikulës, metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimi i arritjes së nxënësve, riorganizimi i kurrikulës me zgjedhje, si dhe aspektet tjera të organizimit në nivel shkolle, DKA dhe MASHT.

Kurrikula e bazuar në kompetenca

Çka është kompetenca?

Kompetenca nënkupton aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.

Kompetencat e parapara me Kornizën Kurrikulare rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Këto kompetenca janë¹:

Kompetencat kryesore	Rezultati përfundimtar
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	Komunikues efektiv
2. Kompetenca e të menduarit	Mendimtar kreativ dhe kritik
3. Kompetenca e të mësuarit	Nxënës i suksesshëm
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis	Kontribues produktiv
5. Kompetenca personale	Individ i shëndoshë
6. Kompetenca qytetare	Qytetar i përgjegjshëm

¹Kompetencat kryesore të arsimit të Kosovës janë të bazuara dhe të ndërlidhura me tetë Kompetencat Kryesore Evropiane për Nxënie Tërëjetësore (Kornizën Referuese Evropiane).

Cilat janë parimet e Kornizës Kurrikulare?

Parimet e Kornizës Kurrikulare janë:

1. Gjithëpërfshirja

Ky parim i referohet së drejtës të secilit fëmijë dhe secilit të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimim cilësor.

1. Zhvillimi i kompetencave

Ky parim nënkupton kompetencat e përcaktuara në dokumente kurrikulare, të cilat arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit.

2. Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent/ të ndërlidhur

Ky parim promovon të nxënit e plotë, duke reflektuar ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që kanë nxënësit për to.

3. Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle

Ky parim përcakton rregullat e autonomisë dhe të fleksibilitetit në nivel shkolle dhe ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e stafit të shkollës për hartimin e planit vjetor të punës, për shfrytëzimin fleksibil të kohës, mjeteve dhe materialeve mësimore, si dhe për planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të kurrikulës.

4. Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Ky parim parasheh vendosjen e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Përgjegjësia dhe llogaridhënia i referohen si procesit të zbatimit të kornizës së kurrikulës, ashtu edhe sistemit të arsimit në tërësinë e tij.

Çka janë shkallët kurrikulare?

Shkallët kurrikulare janë nën nivele formale të arsimit që ndërlidhen me fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe organizimin e procesit të mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit. Ato përbëhen prej një, dy ose tre viteve/klasave.

Shkallë kurrikulare janë gjashtë:

- SHK 1: Parafillor, klasa e parë dhe e dytë;
- SHK 2: Klasa e tretë deri në klasën e pestë;
- SHK 3: Klasa e gjashtë dhe klasa e shtatë;
- SHK 4: Klasa e tetë dhe klasa e nëntë;
- SHK 5: Klasa e dhjetë dhe klasa e njëmbëdhjetë, dhe
- SHK 6: Klasa e dymbëdhjetë.

Çka kuptojmë me fushë kurrikulare?

Fushat e kurrikulës përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet duhet të ndjekin/realizojnë qëllimin dhe rezultatet e të nxënit të përcaktuara për fushën përkatëse të kurrikulës. Disa lëndë të një fushe të kurrikulës mund të mësohen si të integruara në shkallë të ndryshme të kurrikulës.

Fushat e kurrikulës janë:

- o Gjuhët dhe komunikimi,
- o Artet,
- o Matematika,
- o Shkencat natyrore,
- o Shoodëria dhe mjedisi,
- o Edukata fizike, sportet dhe shëndeti,
- o Jeta dhe puna.

Ç'kuptojmë me kurrikulën me bazë shkolle-mësimi me zgjedhje dhe aktivitetet tjera?

Krahas mësimin të detyrueshëm (kurrikulës bërthamë), kurrikula me bazë shkolle ofron mësimin me zgjedhje dhe aktivitetet tjera (mësimi plotësues, shtues, mësimi ekstrakurrikular/jashtëkurrikular, aktivitetet sportive, puna me projekte, aktivitetet artistike etj.), që kontribuojnë në arritjen e kompetencave nga nxënësit dhe njëkohësisht në performancën e shkollës. Ky lloj mësimi ofrohet nga shkolla në bazë të interesimit të nxënësve, nevojave të komunitetit, sugjerimeve që ofron MASHT-i dhe mundësive të vetë shkollës. Mësimi me zgjedhje është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit.

Ç'kuptojmë me rezultatet e të nxënit?

Rezultatet në kurrikulë shprehin atë se çfarë duhet të dijnë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Ato paraqesin një varg domenesh, përfshirë dijen, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

Në dokumente kurrikulare i kemi të ranguar tri lloje të rezultateve të të nxënit:

- rezultatet e të nxënit për kompetencë (shkallë),
- rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare,
- rezultatet e të nxënit për lëndë.

Këto rezultate janë të ndërlidhura mes vete dhe pasqyrojnë atë çfarë nxënësi duhet të arrijë në përmbushjen e kompetencave.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Kurrikula e re kërkon qasje të re metodologjike, e cila ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësi. Kjo metodologji kërkon që mësimdhënësi t'i shmang metodat e punës që prodhonin mësim të memorizuar, të fragmentarizuar dhe abstrakt, duke zbatuar praktika të bazuara në zhvillimin e kompetencave përmes rezultateve, përmbajtjeve të integruara dhe të ndërlidhura me jetën e përditshme.

Mësimdhësi është i obliguar që të reflektojë ndaj pritjeve të kurrikulës së re, duke bërë planifikimet e duhura në koordinim me mësimdhësit tjerë, që çojnë drejt rezultateve të synuara dhe janë në përputhje me interesimet, përvojat dhe diversitetin e nxënësve.

Për të realizuar këtë qasje të re metodologjike, mësimdhësi duhet të përcjellë në

vazhdimësi risitë në fushën/ lëndën e vet, duhet të përdorë strategji dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies, duke respektuar aftësitë, stilet e ndryshme të nxënies, diversitetin dhe rrethanat tjera (socio-psikologjike). Gjithashtu, mësimdhënësi duhet të nxisë të menduarit kritik dhe shkathtësitë tjera tek nxënësi, duhet të përdorë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, si dhe duhet të nxisë bashkëpunimin në mes të nxënësve duke krijuar klimë pozitive të mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë dhe jashtë saj.

Komponentë e rëndësishme e punës së mësimdhënësit është edhe bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin. Prandaj, mësimdhënësi duhet të nxisë format e partneritetit me prindër dhe grupet tjera të interesit, nëpërmjet dialogut të hapur dhe komunikimit e koordinimit të vazhdueshëm në të mirë të arritjes së rezultateve sipas nevojave dhe interesit më të lartë të nxënësit.

Pse dhe si vlerësohet nxënësi?

Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen e informacioneve për përkrahjen e nxënësit (përfshirë edhe nxënësit me nevoja dhe dhunti të veçanta) në zotërimin e rezultateve të të nxënës, në përcaktimin e nivelit të performancës, në raportimin e rregullt të progresit, si dhe në certifikimin dhe orientimin në shkollim të mëtejshëm.

Llojet e vlerësimeve

Korniza Kurrikulare përcakton dy lloje të vlerësimit:

- Vlerësimi i brendshëm,
- Vlerësimi i jashtëm.

Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësimdhënësit e shkollës. Ky vlerësim bëhet për disa qëllime, si për përparimin dhe arritjen në të nxënë, për planifikim të punës me nxënë, për identifikimin e prirjeve dhe talenteve të nxënësve etj.

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit formativ (për nxënie) dhe vlerësimit përmbledhës (të të nxënës).

Llojet e vlerësimit të brendshëm

Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i vazhdueshëm – bëhet gjatë procesit të të nxënës (vlerësimi formativ) dhe në fund të çdo teme mësimore, njësie tematike apo periudhë të mësimin (vlerësimi pëmbledhës);
- Vlerësimi përfundimtar – bëhet në fund të vitit mësimor/vitit shkollor;
- Vlerësimi për shkallë – bëhet në fund të çdo shkalle kurrikulare, përkatësisht në fund të klasave: II, V, VII, IX, XI, XII. Në përfundimin e një shkalle të kurrikulës (klasat: II, V, VII, IX, XI dhe XII) bëhet vlerësimi i nivelit të arritjes së njohurive dhe zotërimit të kompetencave nga nxënësi sipas përcaktimit në kurrikulën bërthamë të nivelit përkatës të arsimit.

Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm është vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënës dhe për zotërimin e kompetencave në fund të nivelit I, II dhe III të arsimit parauniversitar. Ky vlerësim organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT. Me kërkesë të MASHT-it vlerësimi i jashtëm mund të bëhet edhe për qëllime të tjera dhe nga institucione tjera relevante.

Korniza përcakton periudhën e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit/përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve. Gjithashtu, procesi deshifrohet edhe me U.A nr. 08/2016 për vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës Kurrikulare të arsimit parauniversitar, ku krahas formave dhe niveleve të vlerësimit, parashihet edhe mundësia e ankimit për pretendimet mbi vlerësimet diskriminuese/ të padrejta ose ato të gabuara.

Cilat janë periudhat e vlerësimit?

Vlerësimi i brendshëm i nxënësve bëhet në këto periudha:

Periudha 1: shtator- dhjetor;

Periudha 2: janar- mars;

Periudha 3: prill- qershor.

Nxënësit e shkallës I dhe II (parafillor, kl.1, 2, 3, 4 dhe 5) nuk përsërisin klasën (përveç në raste të veçanta, me kërkesë të mësuesit dhe miratim të prindit, apo anasjelltas nxënësi përsërit klasën), por përcillen në klasën vijuese. Mësuesi dhe prindi hartojnë një plan të përkrahjes së nxënësit, të cilin mësuesi e zbaton gjatë vitit vijues mësimor.

Cili është roli i prindërve në mbështetje të zbatimit të Kornizës Kurrikulare?

Roli i prindërve është i përcaktuar me Ligjin nr. 04/L-032 të arsimit parauniversitar, nenet 16 dhe 19, prej nga derivojnë Këshilli i Prindërve të Kosovës dhe këshillat e prindërve në të tri nivelet (në nivel të Kosovës, komunës dhe shkollës).

Prindërit përfaqësojnë interesat e tyre e të fëmijëve të tyre dhe janë partnerë të rëndësishëm në sigurimin e mbarëvajtjes së procesit arsimor, prandaj kontributi i tyre shihet në disa drejtime. Ata kanë rol të konsiderueshëm në vendimmarrje dhe monitorim nëpërmjet të përfaqësimit të tyre në këshillin drejtues të shkollës, në këshillat e prindërve, por edhe si pjesëmarrës në takimet e rregullta me mësimdhënës.

Brenda të gjitha zhvillimeve, arritjeve, sfidave në kuadër të punës edukativo-arsimore, prindi duhet të ketë vëmendje të veçantë edhe ndaj zbatimit të kurrikulës nga mësimdhënësit, duke u bërë bashkëpunues në mbështetjen e fëmijëve dhe shkollës. Gjithashtu, ata duhet të kërkojnë sqarime dhe mbështetje rreth arritjeve ose mosarritjeve të fëmijëve të tyre në fushat e caktuara kurrikuale, por edhe të ofrojnë ekspertizën e tyre në mbështetjen e mësimdhënësve për realizimin e temave, kaptinave specifike, për të cilat ata posedojnë përgatitjen profesionale. Ata mund të mbajnë ligjërata në lëndë të caktuara, mund të sugjerojnë tema e aktivitete në kuadër të planifikimeve periodike, si dhe mund të mbështesin nxënësit dhe mësimdhënësit në realizimin e mësimin jashtë klasave (p.sh orën e biologjisë në laborator, natyrë, ambient me bimë apo kafshë, sipas planifikimeve të përbashkëta, pastaj orën e historisë, në muze, në kala, etj, orën e letërsisë në bibliotekë, teatër, e kështu me radhë...).

Prindërit duhet të kujdesen që stafi administrativ, arsimor dhe ai mbështetës të mos jenë diskriminues dhe neglizhentë përgjatë punës me fëmijë. Prindërit duhet të sigurohen që shkolla e luan rolin e duhur në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe merr parasysh aspektet e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat gjithashtu janë pjesë integrale e dokumenteve kurrikulare (pos atyre ligjore, administrative).

Përfundim:

Informimi është një nga të drejtat themelore të secilit individ. Prandaj, shpresojmë që ky informator do të shërbejë ty si prind që të njohësh proceset nëpër të cilat po ecim si shoqëri dhe të bëhemi bashkudhëtarë në drejtim të avancimit të sistemit arsimor në vend.

